

Terma Reference

Projekti “*Youth for Roma Health*”

I. Informacion i Përgjithshëm:

Autoriteti Kontraktues: Shoqata “Albanian Committee of Medical Students - ACMS”
Emri i Projektit: “Youth for Roma Health”
Kontakti: Henri Fero, ACMS

II. Background

Informacione mbi Organizatën

Rreth nesh – ACMS (Albanian Committee of Medical Students) është një organizatë rinore jo-fitimprurëse me anëtarësi, e themeluar nga studentët e Fakultetit të Mjekësisë Tiranë në prill të vitit 2019. Në gusht 2019 ACMS fitoi kandidaturën për të qenë organizatë anëtare e IFMSA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Studentëve të Mjekësisë, e përbërë nga rreth 120 shoqata në mbarë botën), duke u bërë njëkohësisht përfaqësuesja e vetme zyrtare e IFMSA në Shqipëri dhe duke adoptuar kështu misionin dhe vizionin, strukturën dhe politikën e saj.

Gjatë dy viteve veprimtari, ACMS ka mbajtur një sërë aktivitetesh me interes për studentët e mjekësisë dhe jo vetëm, duke u përshtatur edhe me kushtet e vështira të pandemisë së COVID-19. Me mbajtjen e konferencave, ëbëinarëve, ëorkshopëve dhe fushatave online, ACMS ka siguruar një prani të vazhdueshme të rinjtë që e ndjekin, ku sot numëron 30 anëtarë të plotë dhe rreth 300 të rinj vullnetarë të regjistruar, që angazhohen vazhdimisht në projekte dhe aktivitete.

Vizioni – ACMS synon avancimin e shkencave mjekësore, emancipimin profesional dhe njerëzor të studentëve dhe profesionistëve të rinj të shkencave mjekësore dhe përmirësimin e jetës shoqërore të qytetarëve shqiptarë, duke promovuar barazinë, solidaritetin dhe paqen.

Misioni – Misioni i organizatës është të përfaqësojë dhe integrojë studentë dhe profesionistë të mjekësisë dhe veçanërisht studentë të Mjekësisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në një nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ne jemi një organizatë, e cila lejon studentët e mjekësisë të shprehin idetë e tyre drejt kujdesit shëndetësor, të mbrojnë ndryshimet për përmirësimin e shëndetit për të gjithë, pavarësisht nga përkatësia etnike, statusi socio-ekonomik dhe kulturor.

Fushat e Veprimit – ACMS, falë bazës së gjerë të vullnetarëve të saj, të cilët punojnë vazhdimisht për rritjen e kapaciteteve të organizatës dhe realizimin e projekteve, kontribuon

në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve lokale, me ndërhyrje dhe iniciativa të ndryshme që kryesisht konsistojnë në:

- Aktivizmin për rritjen e cilësisë së edukimit mjekësor në UMT;
- Sensibilizimin për çështjet kryesore të shëndetit publik;
- Ndërgjegjësimin ndaj etikës mjekësore dhe rregullimin e marrëdhënies mjek-pacient;
- Ndërgjegjësimin e publikut ndaj shëndetit mendor dhe luftimin e stigmës ndaj sëmundjeve psikiatrike;
- Ndërgjegjësimin ndaj shëndetit riprodhues dhe parandalimit të infeksioneve seksualisht të transmetueshme;
- Aktivizmin social për të gjitha çështjet që prekin shoqërinë shqiptare dhe vecanërisht të rinjtë;
- Aktivizmin për të drejtat e njeriut, të drejtat e grave, drejtësinë sociale dhe paqen ndërmjet komuniteteve.

Pak mbi projektin:

Komuniteti Rom përjeton diskriminim të gjerë, dhunë dhe përjashtim social. Ky fenomen ka ndërthurur pasoja të cilat mbulojnë shumë sektorë, pasoja që kanë impakt negativ mbi shëndetin e këtij komuniteti.

Sipas OBSH një prej pikave më të dobëta, globalisht, të shumë strategjive të shëndetësisë si dhe programeve kombëtare dhe aktiviteteve është që përdoret një metodikë “top-down” pa konsideruar qasjen “bottom-up”. Kjo në vetvete do të thotë që janë pikërisht ekspertët ata që identifikojnë problemet, formulojnë ndërhyrjet dhe japin zgjidhjet ashtu si ata gjykojnë se perceptohen prej grupeve të riskuara. Në rastin konkret, për shkak të mos përfaqësimit të mirëfilltë të komuniteti Rom në trupat vendimmarrëse, grupet e marginalizuara, rrallë herë kanë mundësinë që të reflektojnë nevojat e tyre konkrete lidhur me problematikat që ata hasin, duke bërë që metodikat “top-down” të mos përfaqësojnë nevojat reale të tyre. Politikat shëndetësore marrin vlerë kur të gjitha target grupet janë të përfshira, në të gjitha aspektet e zhvillimit të politikave dhe programeve, implementimin dhe vlerësimin e tyre final. Promovimi i pjesëmarrjes sociale të njerëzve të target grupeve të ndryshme në këto procese është gjithashtu në koherencë të plotë me principet demokratike..

Ky projekt synon të vendosë të rinjtë në qendër të problematikave që lidhen me shëndetin në komunitetin Rom duke ndjekur një qasje “bottom-up” lidhur me evidentimin e nevojave reale që ky komunitet ka lidhur me shërbimet shëndetësore, duke i parë ato jo vetëm në kontekstin e shëndetit, por edhe në kontekstin social.

Objektivat specifik të projektit:

1. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të një grupi të rinjve lidhur me problematikat e shëndetit në komunitetin Rom si dhe hartimin e një studimi i cili synon të evidentojë në mënyrë “bottom-up” problematikat e komunitetit, duke i përcjellë në trupat politik bërës dhe vendimmarrës;
2. Krijimin e një fushate kombëtare mbi rëndësinë e kryerjes së “screening” duke implikuar masat parandaluese si një prej shtyllave të shëndetit dhe promovimin e sjelljeve të shëndetshme në komunitetin Rom, promovimin e marrëdhënieve seksuale të mbrojtura si dhe planifikimin familjar;
3. Depistimin e popullatës target për HTA (Hipertensioni Arterial) dhe shpërndarjen e informacionit me rëndësi për komunitetin mbi shërbimet shëndetësore si e drejtë themelore;

4. Uljen e stigmës, paragjykimet lidhur me marrjen e shërbimit shëndetësor në komunitetin Rom.

Projekti Youth for Roma Health shkon paralel me misionin dhe vizionin e ACMS, për përmirësimin e shëndetit të popullatës, me fokus të veçantë grupet në risk, për ndërgjegjësimin, advokimin dhe ndërhyrjen në nivel lokal dhe qendror lidhur me çështjet e shëndetit dhe parandalimin, trajtimin dhe përkujdesjen karshi sëmundjeve të ndryshme.

Për realizimin e objektivave të sipërpërmendura kërkohet nga ACMS përzgjedhja dhe angazhimi i një subjekti për një sërë zërash të cilat bëjnë të mundur dorëzimin e një sërë produktesh të cilat sigurojnë suksesin e projektit. ACMS nuk ofron sub-grantim në këtë thirrje pasi ajo është përgjegjëse e drejtpërdrejtë për zbatimin e projektit.

III. Objektivat e zërave për të cilat hapet kjo thirrje:

Zërat për të cilat hapet kjo thirrje janë:

Linjat e buxhetit	Njësia	Sasia
Ekspert për trajnimet (2 trajnime nga 4 dite plus 2 dite përgatitje)	Shërbim (ditë)	12
Facilitator	Ditë	12
Qira për mjete (videoprojektor, bokse)	Për trajnim	2
Ekspert për takimet (ky ekspert do të jetë përgjegjës për monitorimin e të rinjve dhe gjithashtu do të jetë mjek i licencuar)	Shërbim	2
Koordinator vullnetarësh (ky koordinator do të jetë përgjegjës për koordinimin e vullnetareve në nivel lokal dhe gjithashtu do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me ta)	Shërbim	2
Qira për aparate tensioni	Copë	15
Ekspert për përpunimin dhe hartimin e gjetjeve në nivel lokal	Shërbim	1
Grafik Dizajner	Shërbim	1
Ekspert (do të ketë dy ekspert të cilët do të marrin pjesë në takimet dhe do të flasin për rëndësinë e trajtimit në kohë të sëmundjes/ 2 dite)	Shërbim	2
Ekspert për hartimin e ToolKit (do të punojë 12 dite)	Shërbim	1
Grafik Dizajner për ToolKit (do të punojë 12 ditë)	Shërbim	1
Ekspert komunikimi (për gjithë fushatën)	Shërbim	1
Grafik Dizajner	Shërbim	1

IV. Fondi

Fondi nuk do të jetë i përcaktuar publikisht por subjektet kërkohet që të nisin me dokumentacionin e tyre, dhe një ofertë të përcaktuar me shumat që ata kërkojnë për zhvillimin e punës.

V. Afatet Kohore:

Afati kohor për përfundimin e shërbimeve të parashikuara përkon me planin e aktiviteteve.

VI. Dokumentet për tu paraqitur së bashku me Ofertën Financiare:

Subjektet kërkohet të paraqesin dokumentet e listuar më poshtë së bashku me Ofertën Financiare.

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.
2. Kopje e NIPT-it.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose nga autoritetet përkatëse, si dhe vetë deklarin e subjektit.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jo fitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet:

1. Ekstrakt Historik lëshuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “për Organizatat Jo Fitimprurëse”.
2. Një dokument, të lëshuar nga Administrata tatimore që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka shlyer detyrimet fiskale;
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet referuar sigurimeve shoqërore e shëndetësore;
3. Kopje të NIPT-it.

Oferta Financiare, që do të dorëzohet nga Operatorët ekonomikë të ftuar duhet të listojë të gjitha kostot që lidhen me këtë shërbim. Kostot duhet të ndahen sipas zërave të parashikuara. Operatorët ekonomikë të ftuar duhet të theksojnë çmimin e shërbimeve të tyre vetëm në monedhën Shqiptare (Lek).

VII. Kriteret e Vlerësimit:

Komisioni i Vlerësimit të ofertave, do të vlerësojë ofertat në bazë të çmimit më të ulët si dhe sipas dokumentacionit mbështetës që do të paraqesin subjektet (CV apo dokumentacion tjetër që tregon për kapacitetin e subjektit). Këto kriteret janë të vetmit që përcaktojnë ofertuesin më të mirë, duke marrë në konsideratë elementët specifikë statikë të cilësuar në Termat e referencës dhe specifikimet teknike.

Hapat që do të ndiqen nga ana e Komisionit të vlerësimit të ofertave:

- (i) Kontrolli administrativ i Ofertuesve ekonomikë**
- (ii) Propozimi financiar.**

Do të refuzohen ofertat në këtë fazë në rast se nuk i përgjigjet aspekteve më të rëndësishme të Termave të Referencës aktuale.

ACMS ruan të drejtën e përzgjedhjes së subjektit, pa u ndikuar nga të tretë.

VIII. Afati i paraqitjes së dokumenteve

Dokumentet e kërkuara dhe propozimi financiar duhet të paraqiten brenda **30 ditëve kalendarike** nga data e publikimit të kësaj thirrje. Ato duhet të dorëzohen vetëm elektronikisht në adresën e e-mail info@acmsalbania.org. Në subjekt duhet të jetë shkruar “Interes mbi zërat për projektin Youth for Roma Health”. Nëse hapat e mësipërm nuk janë ndjekur në mënyrë korrekte, sipas udhëzimeve të dhëna, oferta nuk do të merret parasysh.

Presidenti Ekzekutiv

Z. HENRI FERRO